

Npi – 01/185 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes të mbajtur më 02.05.2025, është nxjerrë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

I Mbledhjes së Jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,  
e mbajtur më datën 02.05.2025 (e premte), në ora 16:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emimi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Asistentja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti; Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni dhe Albion Shabani; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi.

Për këtë seancë të Jashtëzakonshme kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.02.2025,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi – 01/23 datë: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025,
3. Pasqyrat Financiare per vitin 2024,
4. Propozim per ndarjen e te hyrave te bartura nga viti 2024 per vitin 2025,
5. Propozim-Venmdim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit Npi-01/90 datë 12.03.2025 të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale në Zonën Kadastrale – Davidoc,
7. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 datë:13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes,

8. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të komunës së Shtimes,

9. Pyetje – Përgjigje.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, ju njoftoj se prezent në sallë janë 18 anëtarë të Kuvendit. Meqenëse kemi pas një problem teknik lidhur me mbledhjen e 3 të rregullt MAPL-ja na ka rekomanduar që të mbajmë seancë të jashtëzakonshme në vend të seancës së 3 të mbajtur më 03.04.2025. Këtë seancë e ka thirrë Kryetari i Komunës bazuar në nenin 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040. Hapi diskutimin për Rendin e ditës.

**z.Rexhep Gashi:** Përshëndetje. Të dëgjova me vëmendje, diskutimet janë të lejuara. Materiali na ka ardhur me një sqarim nga Sekretaria. Këtu ka pas shkelje të ligjshmërisë, sepse materiali na ka ardhur më datën 28. Është shkelje me u thirrë mbledhja e jashtëzakonshme me 9 pika, mbledhja e jashtëzakonshme duhet të jetë me 1 pikë. Kjo është një mbledhje ku edhe sot po bëjmë shkelje ligjore. Dy mbledhje për një ditë e keni gabim. Unë jam për me mbajtë mbledhje por jo të jashtëzakonshme, por mbledhje teknike që e ka kthyer Ministria.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Ne mbledhjen e kemi thirrë me kohë më datën 24, por ju materialin nuk keni mujt me marrë me kohë për shkak të volumit të madh të materialit që ka pas problem me bartë deri te E-mailat e juaj, dmth. për shkaqe teknike. Tash pas konsultimit që kemi pas me MAPL-në kemi ardhur në përfundim se duhet ta mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme për ti konfirmuar vendimet që i kemi marrë.

**z.Besnik Seferi:** Përshëndetje. Me rastin e vdekjes të profesorit të nderuar z.Mefail Salihaj, për nderimin e tijë ju ftoj për një minutë heshtje. Për sa i përket pikave të rendit të ditës, nuk është mirë që materiali të vonohet. Kolegë opozitarë ju edhe ashtu nuk keni marrë pjesë në mbledhje, për disa vendime shumë të rëndësishme siç është rrënimi i objektit para Komunës. Më vjen mirë që sot jeni këtu prezent, sepse unë kamë bërë ftesë edhe në mbledhjen e kaluar që të jeni prezent në mbledhje dhe të jepni kontributin e juaj.

**z.Rrahman Jakupi:** Opozita nuk po thot që është e kundërligjshme, por po thotë MAPL-ja. Po e lexoj vendimin e Ministrisë. Nuk është vendim për njoftim. (Në vazhdim lexoi shkresën nga MAPL-ja). Cila është arsyeja e ftesës për mbledhje të jashtëzakonshme?

**z.Reshat Mujota:** Faleminderit për fjalën. Te rendi i ditës, kot mundoheni me e mshefë ose manipulu, ne i kemi marrë E-meilat (Në vazhdim lexoi E-meilat nga sekretaria e Kuvendit).

**z.Përparim Ramusa:** Nuk po kuptoj mjaftueshëm pse nuk po thuani, dhe pse e keni bërë këtë padituri. Nuk e kemi lëshuar mbledhjen ne për pikën 5 por për paditurinë e juaj. Mbledhjen e kemi lëshuar sepse nuk e keni lejuar Kryesuesin e Komisionit për emërtimin e objekteve publike për me raportuar në mbledhje të Kuvendit.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Përshëndetje. Me rastin e ndarjes nga jeta të profesorit Mefail Salihaj i shprehu ngushllime familjes Salihaj. Këtu pra siç edhe po shihet po keqpërdoret audienca para qytetarëve, me ofendime ndaj meje prej të frustruarve. Lidhur me mbledhjen e Kuvendit të 3 Prillit, ne e kemi pranuar një shkresë nga MAPL-ja konkretisht nga znj.Dërguti, me të cilën kërkohet që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme për ti konfirmuar vendimet e marra në këtë mbledhje për arsye teknike sepse siç u tha materiali i mbledhjes së Kuvendit ka qenë voluminoz dhe nuk kanë mujt me e pranuar materialin anëtarët e Kuvendit. Kjo shkresë e Ministrisë nuk është vendim që ka efekte obligative. Aty thuhet për shkaqe teknike. Ftesa për Kuvend është bërë më datën 24.03.2025 dhe materiali është dërguar më datën 26.03.2025, për shkak të ngarkesës është ridërguar edhe më datën 27 Mars por edhe më 28 Mars.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 19 anëtarë.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstënim”, miratoi rendin e ditës.**

## Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.02.2025

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 19 anëtarë.

**\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstënim”, miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më: 24.02.2025.**

## Pika 2

Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi – 01/23 datë: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF:** Përshëndetje. Materialin po besoj e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të lëshohem në detaje por në pikat kryesore. Pra e kemi pranuar një Rekomandim nga Ministria e Shëndetësisë, për me i larguar disa çmime të shërbimeve shëndetësore nga Rregullorja Komunale për Taksa për vitin 2025, dhe me harmonizuar me normat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2024 për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore. Konkretisht këtu po bëhet fjalë për shërbimin paleativ të QKMF-së, këtë shërbim ne do ta kryejmë pa pagesë.

**z.Përparim Ramusa:** Ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim ndryshimin që duhet bërë, në bazë të normave ligjore e të cilin e ka kërkuar Ministria.

**z.Besnik Seferi:** Edhe ne si grup parlamentar i VV-së jemi “Pro”.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 19 anëtarë.

**\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, Npi-01/23 dt. 27.01.2025, si vijon:**

**1. Fshihen nga Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, Npi – 01/23, të datës 27.01.2025, këto nene si vijon:**

- Neni 10.2.5 Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike .....0.30 €
- Neni 10.2.14 Dhënja e injeksionit Intra muskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente 1.00 €
- Neni 10.2.15 Dhënja e injeksionit Intra venoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente .....1.00 €
- Neni 10.2.18 Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Çertifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, bëhet lëshimi i Çertifikatave të shëndetësore në Kujdesin Primar .....15.00 €

**2. Është bërë harmonizimi i neneve 10.2.22 dhe 10.2.25 me U.A. Nr.03/2024 si vijon:**

- Neni 10.2.22 RTG i dhëmbit .....(nga 1.50€ në 1.00 €)
- Neni 10.2.25 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë) .....(nga 5 € në 4.00 €)

## Pika 3

Pasqyrat Financiare per vitin 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF:** Përshëndetje. Më lejoni që përmes kësaj seance ta njoftoj Kuvendin për pasqyrat financiare për vitin 2024. Për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë, dhe e keni lexuar. Unë do ti lexoi pikat kryesore nga dokumenti (shih dokumentin). Buxheti i Alokuar në vitin 2024 ka qenë 11,361,029.00 € edhe pse Buxhetin e miratuar në Kuvend e kemi pas 9,906, 819.00 €. Buxheti për vitin 2024 është shpenzuar 97.2%. Borgji i Komunës është 21,000 € ky është borgji më i vogël që ka pas ndonjëher Komuna e Shtimes. Nëse ka dikush ndonjë pyetje konkrete do të përgjigjem.

**znj.Adelina Beqaj:** Në Nëntor të 2024, ke pas thënë si vijon: (Adelina e lëshoj një inçizim nga telefoni mobil) vlera për drekat zyrtare është 13.000 €. Ti veq drejtor për financa nuk mundesh me qenë, e po për ndonjë drejtori shpifëse.

**z.Besnik Seferi:** Po flasim për raportin financiar, për një raport mjaft të mirë. Po flasim për një Buxhet që ka punë shumë e shpenzime pak, e te opozita ka qenë e kundërta. Të njëjtën gjë po e

thotë partia e njejtë PDK-ja në nivelin qendror se në Shtime po investohet shumë. Unë nuk kamë çka flas sepse puna në teren po fletë vetë. Raporti është bërë mbi bazën e punëve, dhe unë mendoj që secili duhet me ju gëzuar realizimit të projekteve. Ne normalisht jemi “Pro” dhe do ta përkrahim këtë raport.

**z.Përparim Ramusa:** Kolegja paraprake të demantoi me shifra ty drejtor, a skuqesh kur na sheh kur po të demantojmë me shifra si psh. (Në vazhdim lexoi një shkresë).

**znj.Adelina Beqaj:** Qysh ndihesh ti Besnik, kur 17 dreka, kolegët e tu i kanë shpenzuar jashtë Komunës së Shtimes, si psh. te “Hija e Maleve” – Ferizaj etj. Edhe ti e dinë që nuk është në rregull.

**z.Besnik Seferi:** Po i drejtohem qytetarëve, unë nuk jamë bërë pjesë e pazareve politike. Sa i përket raportit të shpenzimeve unë e kamë këtu në telefon, për 6 muaj janë shpenzuar nga ju kur e keni pas pushtetin me 27.000 €, dhe çka keni bërë ju se është pyetja, dhe këtë diferencë nuk mundem pa e përmend.

**z.Asllan Beqaj:** Faleminderit drejtor, për menaxhimin më së miri të buxhetit dhe me transparencë dhe për këtë duhet të krenohesh. Normalisht që ka edhe shpenzime sepse po punohet jashtëzakonisht shumë, kah të sillesh ka vendpunishte duke u punuar në projekte të ndryshme. Prandaj edhe është e mundur që edhe u mirren mendët e nuk i shihni projektet që po realizohen. Është interesant që kur po ka me votu projekte të mdhaja ju po ikni nga mbledhja. Të lumtë drejtor për punën. Kryetarit respekt për investimet që i ka sjellë në Komunën e Shtimes.

**z.Rrahman Jakupi:** Te çështja e drekave zyrtare, atëherë ka pas thënë janë shpenzuar vetëm 300€, dhe po del që janë më shumë. Është çështja me e mshef diçysh, me ndrru terminologjinë. Ju e keni marrë Shtimen me çelsa në dorë, e tash po i shtroni do rrugica. Duhet me ditë se pushteti një ditë mbaron. Nuk bënë me i mbyllë dokumentet e mos me i dhënë kur kërkohet qasje në dokumente zyrtare.

**z.Lumni Amrushi:** Unë e kamë një pyetje për drejtorin, një projekt që është përruruar në vitin e kaluar, po bëhet fjalë për një projekt pak pa shku te pishat, kurë është bërë pagesa e fundit për këtë projekt, dhe kurë është bërë pranimi teknik?

**z.Reshat Mujota:** Sa i përket investimeve, qytetarët u kanë zgjedhë për me investu. Rrugicat vërtetë janë asfaltuar, por qe 4 vjetë mandat nuk rregullohet një treg, pastaj nuk ka ujë të pijes 24 orë ashtu siç keni premtuar. Ku e keni impijantin e ujërave të zeza? Unë jamë për projekte të mëdha, e asfaltimi i rrugicave është për vota. Unë kamë një pyetje te kategoria mallra dhe shërbime aty ku nuk janë shpenzuar këto mjete, propozoj me i qitë te Arsimi sepse është tmerr, nuk kemi shërbime të mira. Pse te Shërbimet Publike nuk janë shpenzuar 84.000€. Te Subvencionet dhe Transferet i ki 50.000€. Dihet që shumat janë të sakta sepse ti nuk mundesh këtu me i qitë shifra të tjera. Por drejtorët po mungojnë në mbledhje për me tregu pse nuk i kanë shpenzuar mjetet.

**z.Asllan Beqaj:** Që të kuptohemi drejt unë asnjëher nuk thash që është investuar vetëm në Petrovë. Unë thash se në Komunën e Shtimes janë investuar rreth 5 milion euro në projekte të ndryshme, dhe unë mendoj se të mirës duhet me ju gëzuar të gjithë dhe me i mirëpritë projektet, e jo me mbajtë inatë.

**z.Reshat Mujota:** Nuk të përmenda me qëllim, sepse unë i përmenda edhe Muhametin edhe Adelinën sepse edhe këta janë të fshatit Petrovë. Dhe për ata PDK-ja sotë janë në opozitë, sepse edhe sot ka lagje që janë pa ujë e pa kanalizim.

**z.Asllan Beqaj:** Unë për secilin fshat kamë kërkuar investime. Nuk është marre me kërkuar edhe për fshatin Petrovë sepse është fshati më i madh.

**znj.Adelina Beqaj:** Unë këshillën e Reshatit e marrë si të mirëqenë. Ju nuk mundeni me e konstatuar punën time.

**z.Asllan Beqaj:** Unë frikë nuk kamë ndaj askujt, e nuk ndikojnë as individ e as shoqata.

**z.Kadri Emini:** Kryesues menagjoj më mirë replikat, sepse nuk mund të shkojë në pafundësi me këto replika duke ja përmendur emrin njëri tjetrit. Drejtori i financave nuk mundet me menagju me shpenzimet e drejtorive e as të zyrës së Kryetarit. Ky as nuk është ekzekutues i

shpenzimeve pa Kryetarin. Ky i bjen shifrat në Kuvend dhe i prezanton. Gjithë ka me pas shpenzime për dreka zyrtare, spse nuk shkon në traditën tonë, vjen një investitor për të mirën e Komunës tonë, e mos me ja qitë një kafe nuk shkon. E përgëzoj drejtorin kështu që ne do ta përkrahim raportin dhe jemi "Për".

**z.Rexhep Gashi:** Kur thuhet se legjislatura e kaluar ka bërë më shumë shpenzime, ne kemi kërkuar ndryshime. Tash po na del 12.000€ me mbi 1000€ në muaj. Fshati Pjetërshticë është në të gjitha sferat mbrapa. Te ndriçimi publik aty veç kablla kemi ndërsa ndriçimi 80% nuk është funksional. Te obligimet e Gjykatës që e ka nxjerrë Kryetari që nuk paguhen por lejohet të paguhen shpenzime shtesë me përmbarues. Te zyra jote Kryetar është shqetësuese fakti që e ke marrë me 10 puntorë e i ke ba 18 punëtor.

**z.Muhamet Ademaj:** Ne kemi folë për këtë raport në seancën e kaluar, dhe e përkrahim këtë raport. Shqetësues është niveli i gjuhës shumë të ulët që po përdoret në këtë Kuvend, sepse mandati kryhet shumë shpejt po ku po mbesim ne. Unë kamë respekt për Kryetarin edhe më herët por edhe tani.

**z.Besnik Seferi:** Po më vjen keq shumë kur po bëhen krahasime, jo lagja jem, jo fshati jem, kjo është për keqardhje. Sot na është dhënë një mirnjohje nga KDI-ja ku Shtimja është një ndër Komunitat më transparente.

**- Seancën e Kuvendit përkohësisht e Kryeson anëtari më i vjetër z.Muhamet Ademaj, sepse Kryesuesi z.Adnan Ademaj e largohet përkohësisht për nevoja personale.**

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Po dëgjojmë këtu në seancën e Kuvendit lloj lloj fjale, si psh. fjala (llom). Nëse po e përdorni këtë fjalë atëherë ta dini se llom ishte në kohën e juaj kur në ç'do shkollë ishin të vendosura nga 20 kova të vendosura në rastet kur binte shi për me i grumbullu pikat e ujit që pikonte nga qatia gjithandej gati në të gjitha shkollat e Komunës tonë. Pastaj shkolla te Lagja e Pajtimit fëmijët janë ngrohur me thëngjill, tu bashkjetu fëmijët me tymin e thëngjillit në klasë. I kemi gjetur punëtorët teknik duke pastruar shkollën me një drrasë të improvizuar në formë të shkronjës (T) dhe të pshtjellur me batanie të vjetër nga ndihmat. Tani investimet i kemi shpërnda proporcionalisht aty ku ka pasë nevojë. Kemi 5 shkolla me renovime complete. Kemi 4 salla sportive në Zborc, Reçak, Godanc dhe Muzeqinë. Kemi 6 Laboratore të reja në shkolla. U tha që Kryetari e ka rritë numrin e punëtorëve nga 11 në 18. Duhet me ditë se për Zyrën e Kryetarit ka një organogram i cili e përkufizon saktë numrin maksimal të punëtorëve në 11, dhe ky numër nuk mund të tejkalohet, prandaj nuk bën të shpifet. Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, unë i bëj thirrje të gjithë gazetarëve hulumtues që të hulumtojnë dhe nëse gjejnë në ndonjë komunë shpenzime më të vogla se sa unë në zyrën e Kryetarit, unë jap fardo llogarie që kërkohet. Unë e di e besoj edhe ju disa e dini që kjo është pika ime më e fortë për sa i përket ruajtjes së parasë publike dhe kursimit. Mbi 17 delegacione i kemi pas në komumën tonë nga jashtë dhe nga brenda. Në shumë vizita që kamë pasë jashtë kurrë unë nuk kamë marrë mëditje, por përkundrazi unë kamë gjetë mënyra që mos me i harxhu mjetet pa nevojë nëpr hotele të shtrejta, ka ndodhur shpesh herë që kam kaluar net të tëra qoftë te shokët e mi ose te familjarët kur ka qenë e mundur me qenë afër tyre në Gjermani. Prandaj krejt pa shpenzime nuk ka mundësi me kalu por ka mundësi që mos me bërë shpenzime të panevojshme.

**z.Reshat Mujota:** E dëshmove vetë se nëpër shkolla gjendja është (llom). Gjimnazi është (llom), trego konkretisht në cilat shkolla ka pikë qatia. Kamë një pyetje, sa drejtor i ke të përzgjedhur, vetëm 2 të tjerët i ke ushtrues detyre. Rexhep Hasani ka dhënë dorëheqje prej drejtorit e ke bërë ushtrues detyre.

**z.Përparim Ramusa:** Nuk po muj me heshtë kundër prrallave të Kryetarit. Qemajl Aliu e ka degraduar arsimin. Çdo vit bënë propaganda me shifra. E salla e sportit në Zborc ende nuk ka përfunduar. Ky propagandën e ka në gjep.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF:** Sa i përket të hyrave vetanake Shifra është 71.800€. Në vazhdim drejtori lexoi tekstin e raportit sipas shifrave të shpërndara në kategoritë ekonomike (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje tjetër do të përgjigjem, ju ftoj që ta miratoni pasqyrat financiare.

**z.Përparim Ramusa:** Unë nuk punoj te kuponat fiskal, unë punoj mjek dhe nuk kam se si të ndikoj te pagesat e participimit të pacientëve. Ky drejtor vërtetë nuk qenka mirë.  
**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 15 anëtarë.  
\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 4 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi Pasqyrat Financiare për vitin 2024.**

#### Pika 4

##### Propozim per ndarjen e te hyrave te bartura nga viti 2024 per vitin 2025

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Këtë pikë e ka miratuar edhe Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete. Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja jap Besnik Ahmetit.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF:** Edhe për këtë pike materialin e keni marrë me kohë. Shuma totale që duhet të bartet nga vitin 2024 në vitin 2025 është 266,448.06. Ne i kemi propozuar që këto mjete të ndahen në 13 kategori, e të cilat fillimisht janë plotësuar te projektet e pa kryera. E kam edhe një propozim konkret që nga ketegoria e Subvencioneve shumë prej 30.000€ të bartet nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe të dërgohet te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Në vazhdim drejtori sqaroi për secilën kategori veç e veç, (Shih dokumentin)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 15 anëtarë.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 3 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, miratoi vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 për vitin 2025.**

#### Pika 5

##### Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa:** Edhe atëherë edhe tash në parim ne nuk jemi kundër, por unë e kamë këtu listën e pronarëve që disa janë serbë. Ne po kërkojmë arsyeshmëri, dhe po kërkojmë sqarim për pronarët serbë, sepse me shku paret e shpronësimit në Krlevë te ata që kanë abuzuar me këto prona por edhe kanë abuzuar me vetë shpirtin tonë, kjo nuk është duhet të lejohet. Prandaj ne po kërkojmë që saktësisht të dihen se kujt i takojnë pronat para se të marrim këtë vendim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Nëse ka ndonjë parregullsi lidhur me definimin e pronarëve, atëherë me këtë çështje duhet të merret Gjykata.

**znj.Adelina Beqaj:** Qyshë është e mundur me u rrënu objekti, që njerzit kanë biznes aty dhe e mbajnë familjen. Me rrënu pa e ofruar asnjë alternativë siç është psh. Xheti, kte e njofin të gjithë në këtë rrethinë, është veteran i UÇK-së, e soty po përballet me rrezikun që po i shkatërrohet e ardhmja e familjes, e që ju nuk e keni vetë për asgjë.

**z.Besnik Seferi:** Kemi folë mjaftë shumë, por puna më e mirë që po bëhet është rrënimi i këtij objekti, me qëllim të krijimit të një sheshi për qytetarë dhe një parkingu nëntoksor. Përveq që ka shumë arsye për rrënimin e tijë, ne kemi edhe raporte të policisë për rrezikshmërinë që paraqet ky objekt qoftë për brenda me xhama e dyer të thyera qoftë përjashta ku është dëmtuar struktura e objektit nga që pikon shiu gjithandej. Ky objekt nuk ka asnjë njeri që përkujdeset për te, aty ndodhin gjëra të kqija kështu që unë jamë “Për” sepse komuna ka nevojë për me u ndryshu dhe me i rritë hapsirat dhe parqet publike. Unë mendoj se te ky projekt nuk duhet me pas hamendje për me votu, ne si VV-ë jemi “Pro”.

**z.Muhamet Ademaj:** Unë kamë diskutuar edhe në seancën e kaluar, unë normalisht që e përkrahu këtë investim që arrinë shumë e 3 milion eurove. Rrënimi i objektit duhet të ndodhë edhe atë sa më parë sepse është ndërtuar nën masat e dhunshme të serbisë, pastaj ky objekt tani po paraqet rrezik për qytetarët, kështu që ne jemi “Pro”, që ky objekt të rrënohet, dhe të kompenzohen pronarët.

**z.Reshat Mujota:** Unë e kamë bërë edhe një reagim publik për këtë çështje, sepse ka procese Gjyqësore. Ne jemi për me u hjekë ky objekt, dhe kemi kërkuar shtyrjen e mbledhjes për me pas

informata të mjaftueshme lidhur me projektin për rrënimin e këtijë objekti. Sa e di unë këtë e ka ndërtuar një firmë ndërtimore “Gragjevinar”. Projekti 3 milion euro, nëse është me shpronësime, atëherë nuk janë 3 milion investime. Këtu duhet me pas garancion, dhe me pas kujdesë. Duhet me qenë drejtori prezent dhe me dhënë sçarime.

**z.Kadri Emimi:** Unë kamë kërkuar që kjo pikë me u shty, për me e analizuar secilën situatë, me qëllim që vendimi mos me na u kthyer nga MAPL-ja. Unë e kamë hulumtuar pak, neve duhet me na interesu se a është ky projekt në interes të qytetarëve, nëse po atëherë secili duhet me votu “Për”. Nëse ka paqartësi rreth definimit të pronarit atëherë Gjykata e vendos se kush duhet ti merr paret. Komuna e prishë objektin, nuk paguan asgjë. Pronarët që janë të kënaqur i marrin paret e ata që nuk janë të kënaqur e kanë të drejtën e ankesës. Unë konsideroj se është interes jashtëzakonisht i madhë që ky objekt me u shpallë me interes të përgjithshëm për me ju hapë rrugë shpronësimit dhe pastaj rrënimin, me qëllim të realizimit të projektit të sheshit dhe parkingut nëntoksor.

**z.Përparim Ramusa:** Neve duhet me na interesu se edhe kush i merr paret, nëse i merr një invalid i luftës. Por edhe nëse i merr një njeri serb nga Kraveva që potencialisht mundet me qenë i përfshirë në krime lufte.

**z.Kadri Emimi:** Neve na interson që paret me i marrë pronari i vërtetë. Janë disa serbë në konteste, por pronarë realë nuk ka, e di pak a shumë këtë.

**z.Reshat Mujota:** Pyetje për Kadriun si jurist. U tha që është ndërtuar atëherë nën masat e dhunshme, a do të thotë që edhe paret kemi me ua dhënë në mënyrë të dhunshme? A e di që aty ka edhe prona të AKP-së, duhet me marrë pëlqim nga ky.

**z.Kadri Emimi:** Nëse ka prona AKP-ja i paguhet edhe AKP-së sikurse pronarëve të tjerë. Procedura Gjyqësore e ndalon që ti ipen paret atijë që nuk është pronarë.

**z.Lumni Amrushi:** Pyetje për Kadriun, është mirë me sqaru pajtueshmërinë për me shpallë me interes të përgjithshëm, a kanë të drejtë pronarët mos me u pajtuar me vendimin e Kuvendit?

**z.Kadri Emimi:** Nuk jamë i thirrur dhe nuk paguhem për këshilla juridike. Unë e dhashë mendimin tim. Uroj që për këtë projekt mos të kemi pengesa ligjore.

**z.Asllan Beqaj:** Edhe në mbledhjen e kaluar kemi qenë “Pro”, edhe tani jemi “Pro”, sepse ky objekt i ka dhënë këtijë ambienti hije të keqe. Duhet me ditë se ky objekt nuk është i Kryetarit që po don me prish e me ndërtu ndonjë hotel për interes të vetin, por për interes të qytetarëve.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Ne këtu nuk jemi kundër bizneseve, e aq më pak kundër veteranëve e invalidëve të luftës. Angazhimi ynë ka me qenë maksimal që askush mos me psu humbje as në shpronësim, as në punësim e as sa i përket biznesit. Xheti është i njohur edhe për mua por edhe për shumicën e banorëve të Shtimes si një punëtorë i madh dhe biznesmen i suksesshëm.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 16 anëtarë.

**\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 1 votë “Kundër” dhe me 3 vota “Abstënim”, miratoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristobanesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime.**

**z.Lumni Amrushi:** Deklaroj konflikt Interesi, sepse unë në këtë objekt kamë pronë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Pauzë prej 5 minutave në ora 19:05h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Vazhdimi i seancës në ora 19:10h. Vazhdojmë me pikën e 6.

#### Pika 6

Shqyrtimi i Rekomandimit Npi-01/90 datë 12.03.2025 të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale në Zonën Kadastrale – Davidoc

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Këtë pikë e ka miratuar edhe Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete. Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Reshat Mujota:** Sa i përket kësaj pike, unë kamë qenë pjesë e Komisionit. Mirë kishte me qenë që me raportu Kryetari i Komisionit. Votën në Komision unë e kamë dhënë “Për”, edhe

këtu do ta jap "Për", por në mandatin e kaluar ju keni kërkuar që dhënja e pronës në shfrytëzim të ndalet, dhe unë kamë shprehë disa paknaqësi të miat sepse nga VV-ja thojshin kriminelët po i japin pronë kriminelëve, edhe drejtori i Urbanizimit ka qenë "Kundër" e tash është "Për". Në mandatin e Qemajl Aliut, është shfrytëzuar ai vend pa asnjë kompenzim. Ato kritere janë vetëm në letra sepse ai i ka bërë ato investime aty sa ka qenë e uzurpuar. Kur nuk keni mujt ju me nalë uzurpimin, pse unë me u bërë i keq e me votu "Kundër", kur ai veq po e shfrytëzon atë pronë.

**z.Përparim Ramusa:** Veq u thanë nga parafolësi ato qka desha me i thënë unë. Qemajl Aliu ka thënë krimineli po i jep pronë kriminelit. Ju duhet me i kërku falje njeriut. Në parim unë jamë "Pro" për bizneset.

**z.Kadri Emini:** Ju i dini qëndrimet e mija, ne jemi "Kundër", por e di që është proces i pandalshëm. Çka ka me investu ai në këtë pronë, që keni me ja dhënë?

**z.Muhamet Ademaj:** Këtë vendim e kemi votuar në seancën e kaluar, dhe prap do ta votojmë.

**z.Besnik Seferi:** Unë te ky vendim do të "Abstenoj", sepse u fol këtu për qëndrimet e mija, por le të dihet se unë nuk jamë "kundër" asnjë biznesi.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Disa sçarime po i jap. LVV-ja asnjëherë nuk ka qenë "Kundër" dhënjes së pronave komunale në shfrytëzim për bizneset. Nëse dikush folë personalisht, ai nuk e përfaqëson LVV-në. Gjatë fushatës kamë qenë i përfshirë edhe unë, por nuk është thënë diçka e tillë nga strukturat e Vetëvendosjes. Kryetari asnjëherë nuk ka folë fjalë të tilla siç po thuhet këtu "kriminel", prandaj duhet me pas kujdes kur thuhet diçka e tillë, dhe mos me shpifë. Ky rekomandim që e keni pranuar për këtë pikë nuk ka ardhur nga drejtori i urbanizimit por nga Komisioni për dhënjën e kësaj prone në shfrytëzim afatgjatë. Dhe rekomandimi i Komisionit është me ja dhënë pronën kësaj firme. Anëtarë i Kuvendit ka ikur nga mbledhja dhe pastaj ka shkuar dhe është takuar me biznesin dhe i ka thënë se për tjetër send e kam lëshuar mbledhjen, kështu ka thënë zotëri Ramusa.

**z.Përparim Ramusa:** Kryesues e thae se unë kamë biseduar me biznesin, siç e din unë e kam votuar në KPF-ë, edhe më herët në të kaluarën e kamë votuar, edhe atëherë edhe tash e votoj, mirëpo me biznesin unë asnjëherë nuk kamë folë për prona, ju betohem në fëmijët e mi. Buxhetin nuk e votojmë sepse Kryetari është menagjer i keq.

**z.Besnik Seferi:** Unë jamë në LVV-ë por që ta dini mirë unë nuk jamë njeri i pazareve.

**z.Përparim Ramusa:** Nuk e di mirë se në cilin vit ka ndodhur por e di që nuk e ke votu Buxhetin dhe e ke lëshuar mbledhjen e Kuvendit për arsye të punësimit të bashkëshortes.

**z.Besnik Seferi:** Unë nuk kamë bërë asnjëherë pazare, përkundrazi unë mburrem me punën e bashkëshortes.

**z.Reshat Mujota:** Komisioni ka rekomanduar për me ja dhënë pronën dhe unë kamë me votuar "Për", por këtu nuk ka parime fare sidomos nga VV-ja.

**z.Asllan Beqaj:** Nëse është e pa ligjshme Reshat atëherë pse e ke nënshkruar në Komision. Unë flas në emrin tim, unë personalisht jamë "Për" me i përkrahur bizneset. Nëse ka diçka atëherë tash duhet të flasim e jo pasi të jetë votuar ky vendim.

**z.Reshat Mujota:** Drafti ka qenë publik, u kanë dashtë me konkuru më shumë por nuk kanë konkurruar, unë nuk e di pse. Unë e di që nëse kthehet prona ka me tu kthy ty Kryesues. Sa për mua le të merret prokuroria me te e unë do të jap dëshminë time.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Unë distancohem nga kjo gjuhë. Këta dy persona kanë mëkate nga e kaluara, kështu që edhe Kryesuesi i demaskoi. Nëse dikush e ka mizën ner kapuç për më herët le të mbetet punë e tyre. E sqaroi Kryesuesi se Komisioni është marrë me këtë çështje. Dallimi në mes të Komisionit të atëhershëm dhe punës së Komisionit të tanishëm është se këta të tanishmit nuk përfitojnë nga 5 ari tokë e as banesa në Ferizaj siç ka ndodhur atëherë kur ishit në pushtet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 15 anëtarë.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 1 votë "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenuim", miratoi vendimin që t'i japë në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes Nr.P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej 2894m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale - Davidoc, me kompensim, firmës S.T.N. "BETON" SH.P.K – Davidovc, me përfaqësues z.Shqipdon Abazi.**



Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 datë:13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Këtë pikë e ka miratuar KPF-ja. Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Adelina Beqaj:** Si Komision na e kanë sjellë një Rekomandim, të cilin e kamë lexuar. Unë e kamë një pyetje se pse nuk është marrë parasysh kërkesa e Alban Rashitit, lidhur me kërkesën e tijë për ndryshimin e emrit të sheshit në fshatin Petrovë që të hiqet emri i tanishëm “Shaban Jashari” dhe të emërtohet me emrin e ri “Dëshmorët e Petrovës”. Po ashtu kërkoj që të merret parasysh edhe kërkesa e Selami Rashitit për emërtimin e rrugës së re me emrin e veteranit “Zejnush Rashiti”.

**znj.Zejnije Veliu:** Përshëndetje. Si Kryesuese e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes, i kemi mbajtur 6 mbledhje të Komisionit, ku gjithësejt 19 kërkesa i kemi shqyrtuar, 11 prej tyre janë dhënë rekomandime për miratimi ndërsa për 8 janë dhënë rekomandim për ti refuzuar. Sa i përket refuzimit të kërkesës së Alban rashitit, komisioni ka vendosur të refuzohet dhe mundesh me i pa arsyet në Procesverbalet e Komisionit, edhe ti por edhe kush do tjetër. Sa i përket kërkesës të Selami Rashitit nga fshati Petrovë për emërtimit të një rruge të re, te restorant “Lisi” e cila lidhet me rrugët “Skender Salihaj” dhe rrugën “Ahmet Shtimja”, unë jamë konsultuar me zyrtarin e Urbanizmit dhe Gjeodezisë ku është konstatuar se kjo rrugë nuk është e hapur deri në fund, për këtë arsye nuk kemi mujt me ja dhënë dritën jeshile. Por në rekomandim e kemi potencuar se kur të hapet rruga mundet me u bë emërtimi i sajë. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave ka identifikuar se:

Në Komunën e Shtimes ka më shumë se 200 rrugë ose segmente rrugore që kanë nevojë për emërtimin e tyre.

Komisioni ka identifikuar se ka disa rrugë të cilat janë të emërtuara me vendimin e Kuvendit Npi-01/80 datë 05.04.2013, mirëpo nuk janë të inkuorporuara në Sistemin Elektronik të Adresave. Si dhe ka disa rrugë që janë në Sistemin Elektronik të Adresave por që nuk ekzistojnë fare në Vendimin e Kuvendit, Npi-01/80 datë 05.04.2013, e as në ndonjë vendim tjetër.

Kështu që Komisioni ka dhënë këtë: *REKOMANDIM: Rrugët që nuk janë në Sistemin Elektronik të Adresave e të cilat janë në Vendim të Kuvendit, duhet të futen në Sistemin Elektronik të Adresave. Te rasti tjetër të gjitha rrugët të cilat janë në Sistemin Elektronik të Adresave dhe nuk janë në vendimet e Kuvendit duhet të shlyhen nga Sistemi Elektronik i Adresave dhe gjendja të kthehet në pikën ku kemi harmonizim të plotë në mes të Vendimit të Kuvendit dhe Sistemit Elektronik të Adresave.*

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Komisioni, ka respektuar procedurat administrative, dhe kriteret që kanë ekzistuar. Te rasti i sheshit në Petrovë, nuk ka pas nënshkrime të banorëve, për me ndryshu emrin e sheshit nga “Shaban Jashari” në emërtimin “Dëshmorët e Petrovës”.

**z.Përparim Ramusa:** Pajtohem me Adelinën, Komisioni e ka quajtur kërkesë individuale ndërkaq që Alban Rashiti, është ende Kryetar i fshatit dhe është Drejtor i shkollës, e nuk është veç individual. Unë po kërkoj që me u shty kjo pikë.

**z.Besnik Seferi:** Unë e falënderoj Komisionin si dhe e falënderoj Kryetaren e Komisionit Zejnije Veliu për punën e madhe që e ka bërë në këtë Komision, sepse vërtetë është dashur një punë e madhe për të ardhur deri te një përfundim. Unë nuk jamë kundër kërkesës së personit por edhe nuk jemi asnjë kundër rregullave dhe kriterëve. Me siguri që do të kemi edhe Komisione të tjera për emërtimin siç u tha edhe të 200 rrugëve të tjera.

**z.Muhamet Ademaj:** E vlerësojmë punën e mirë që e ka bërë Komisioni. Ne e dimë për kërkesat e fshatit Petrovë, për mësuesin tani të ndjerë Zejnë Rashiti, kemi respekt dhe unë mendoj se është mirë me pas një rrugë emrin e tijë.

**z.Kadri Emini:** I kamë mbetur borgj Arsim Sylës për me marrë pjesë në mbledhje dhe me trajtu kërkesën e tijë, por në Komisionin e radhës ka me u realizu kërkesa sepse është e drejtë.

**z.Reshat Mujota:** Kisha pas qef me ditë a ka pas peticion, sepse kërkesat qenkan individuale. Unë jamë për këtë shesh të Petrovës që të ndrrohet emri nga “Shaban Jashari” në emrin e ri “Dëshmorët e Petrovës”, ndryshimin e me ba o ky Komision ose Komisioni tjetër.

**z.Asllan Beqaj:** Ne nuk jemi kundër emërimit të këtijë sheshi, sepse është një park shumë i mirë që është ndërtuar tash së fundmi, mirëpo thjesht duhet ti përmbahemi kritereve.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 15 anëtarë.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstënim”, miratoi vendimin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, shesheve, dhe hapësirave publike në Komunën e Shtimes.**

#### Pika 8

Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të komunës së Shtimes

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Rrezartë Ramadani:** Përshëndetje. Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit”, ne në Komision i kemi shqyrtuar dy propozimet e Kryetarit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” ku janë propozuar Prof.Fadil Hysaj dhe Prof.Ismajl Hasani (post mortum). Në vazhdim foli për vlerat e këtyre dy kandidatëve, ku për kandidatin Prof.Ismajl Hasani (post mortum) vuri në spikamë përveq kontributit të madh në fushën e shkencës dhe edukimit të brezit të ri, ai ishte i angazhuar edhe politikisht, ku kishte kandiduar edhe për Kryetarë të Komunës së Shtimes nga subjekti i LDK-së. Edhe kandidati tjetër Prof.Fadil Hysaj, ka dhënë një kontribut të madh edhe për Shtimes por edhe shumë më gjerë në fushën e Kulturës. Përveq shumë veprave të tijë artistike, filmike e dramaturgjike, do të veçoj angazhimin e tijë të madh në organizimin e festivalit ndërkombëtar “Etno-Fest” në fshatin Kukaj.

**z.Përparim Ramusaj:** Ne si subjekt politik i PDK-së nuk i kontestojmë këto figura. Por ne i kemi edhe dy figura për me i propozuar për tua ndarë këtë çmim “Nderi i Qytetit”. Propozimi i parë është që ky çmim ti ndahet edhe të ndjerit Sherif Beqa - Shtime. (Në vazhdim lexoi një shkresë për biografinë e tijë). Propozimin e dytë e kemi për të ndjerin Haki Baftiu – Davidovc. (Në vazhdim lexoi shkresën për biografinë e tijë). Pra ne po kërkojmë që emrave të propozuar nga Kryetari, z.Fadil Hysaj – Shtime dhe Ismajl Hasani – Shtime (Post Mortum) ti bashkangjiten edhe emrat e Sherif Beqa – Shtime (Post Mortum) si dhe Haki Baftiu – Davidovc (Post Mortum), si dy figura të shquara të komunës tonë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Janë figura të merituar, mirëpo rregullorja e thotë që çdo kërkesë duhet të rexhistrohet në protokoll me qëllim që të trajtohet pastaj në Komision. Kërkoj mirëkuptim që kërkesat të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në Zyrën Pritëse.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoj Kuorumin, prezent në seancë janë 15 anëtarë.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstënim”, miratoi vendimin për ndarjen e Çmimit “Nderi i Qytetit”, të Komunës së Shtimes, për profesorët e suksesshëm të Komunës së Shtimes, si vijon:**


1. Prof. Fadil Hysaj – Shtime,
2. Prof. Ismajl Hasani – Shtime, (Post mortum)

#### Pika 9

##### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse diskutime për këtë pikë nuk ka mbledhjen e Jashtëzakonshme e përfundoj në ora 20.31h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

